



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 4 DHE 5 SHTATOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 4. I 5. SEPTEMBRA 2018. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e Ekipit Negociator për Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

## **Dnevni red**

1. Razmatranje narct-odluke Vlade Republike Kosova za imenovanje Pregovoračkog tima za normalizaciju odnosa između Republike Kosova i Republike Srbije

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Qytetarë të nderuar,  
Medie,

E kemi pasur në ndërkohë një situatë që një nga kolegët deputetë ka pasur emergjencë dhe është shtruar në Emergjencë, kanë shkuar edhe dy deputetë me të, është njëra nga arsyet të kësaj situate, ta kemi parasysh. Po shpresojmë se gjendja është më stabile, ka ndodhur në sallën e Kuvendit, në momentet e fillimit të seancës.

Do të thotë, e kemi një situatë që ka qenë e papritur, shpresojmë se gjendja do të jetë e mirë dhe presim, se për fillimin e seancës duhet të jenë 61 deputetë, ndërkohë edhe një deputet është në hyrje dhe do ta fillojmë seancën menjëherë.

Të nderuar deputetë,  
I nderuar kryeministër,  
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,  
I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Republikës së Kosovës me kërkesë të kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj. Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 61 deputetë. Fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

### **1. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikë së Kosovës për emërimin e Ekipit Negociator për Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë**

Të nderuar deputetë,  
Qeveria e Republikës së Kosovës ia ka parashtruar Kuvendit propozim-vendimin për emërimin e Ekipit Negociator për Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. E ftoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që në emër të propozuesit ta paraqesë dhe arsyetojë propozim-vendimin.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar nënkryetar të Kuvendit,  
Kabinet qeveritar,  
Deputetë të respektuar,  
Medie,

Qeveria e Kosovës e sjell para Kuvendit për aprovim propozim-vendimin për Ekipin Negociator të Kosovës. Në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Republikës së Kosovës do të përfaqësohet me

këtë ekip negociator: Fatmir Limaj, kryesues; Enver Hoxhaj, zëvendëskryesues; Behgjet Pacolli, anëtar; Dardan Gashi, anëtar; Mahir Jaghillar, anëtar; Avni Arifi, anëtar.

Po ashtu, në këtë ekip rezervohen vendet për përfaqësuesit e opozitës, përfaqësues nga LDK, Vetëvendosje, PSD, Alternativa dhe nga shoqëria civile. Njëkohësisht, Parlamenti i Kosovës, duke ia dhënë besimin Ekipit Negociator, po ashtu mund t'ia kërkojë edhe platformën për negociim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, i nderuar kryeministër!

Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk e kanë kërkuar fjalën. Nga Partia Demokratike e Kosovës, zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,  
Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh që kjo çështje është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe ka kaluar me të vërtetë një kohë e gjatë e diskutimeve, dhe tryezave, takimeve të ndryshme për tentuar për ta arritur një konsensus nacional në lidhje me dialogun në Bruksel, ne besojmë se vendimi i Qeverisë është vendim i drejtë dhe duhet ta mbështetim të gjithë bashkërisht, kështu që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ne i japim mbështetje dhe do ta votojmë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Vetëvendosje, nga Grupi Parlamentar Partia Socialdemokrate..., nga Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka zoti Ahmet Isufi.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Meqë edhe më herët është kërkuar që Qeveria të jetë udhëheqëse e këtij dialogu, atëherë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah, duke pasur gjithmonë parasysh zbatimin e Kushtetutës, respektimin e integritetit, sovranitetit të vendit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe nuk e ka kërkuar fjalën. Nga Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate, zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje për ju kolegë,

Qytetarë të nderuar,

Zoti kryetar,

Ka kohë që s'jemi parë dhe seanca e parë na doli të jetë seanca për atë që nuk kemi mundur ta bëjmë pothuajse për gjashtë muaj, që ta caktojmë një delegacion të emëruar nga Qeveria, për të vazhduar, për të filluar, për të përfunduar, quajeni si të doni, dialogun me Serbinë.

Megjithatë, nuk është bërë krejt ajo që kemi kërkuar. Nuk është, le të themi projekti për ta ndërtuar një ekip negociator, me të cilin Qeveria do t'i udhëhiqte negociatat në përgjithësi, e ngarkuar nga Kuvendi, nuk është realizuar në plotësi, për faktin se këto bisedime, do të thosha i kanë dy agjenda: agjendën e Qeverisë, e cila thotë se nuk do të negociohet për territorin e Kosovës, që e ka përsëritur kryeministri në vazhdimësi, Qeveria, dhe zëvendëskryeministri Limaj, i cili tash është emëruar për ta udhëhequr delegacionin qeveritar, dhe e kemi një segment tjetër, një komponentë tjetër të krejt këtij procesi, që është presidenti Thaçi, i cili publikisht deklaroi se bisedimet duhet të zhvillohen në atë drejtim që të mos përjashtohet as korrigjimi i kufirit, dikush i thotë “ndarje”, dikush i thotë “shkëmbim”, dikush “korrigjim”. Pra, kemi të bëjmë me dy, nëse doni quani “agjenda, ose këndvështrime”, nëse doni “koncepte”, por janë dy, për të cilat unë pres dhe besoj që duhet të shkrihen në një dhe ajo shkrirja në një i takon tani Parlamentit të Kosovës nëpërmjet një platforme që do të duhej të na e parashtrojë këtu Ekipi Negociator, jo vetëm pozitës, por edhe opozitës dhe qytetarëve në tërësi.

Nëse nuk arrihet kjo shkrirje, atëherë praktikisht do t'i kemi dy delegacione që shkojnë në Bruksel: një i Qeverisë dhe një i Presidentit, që do të hyjnë bashkë në një sallë, por me porosi dhe me mandate krejt të ndryshme. Qeveria e ka një mandat, apo delegacioni do ta ketë një mandat nga Parlamenti nëpërmjet Qeverisë dhe Presidentit, i cili konsideron se e ka një liri më të madhe të veprimit, sepse nuk është i mandatuar nga askush, por thjesht për nga detyra zyrtare si president i vendit ai mund të hapë çfarë do teme në bisedime me Serbinë. Pra, ky është realiteti në të cilin po fillon ky proces. Nëse nuk arrihet një platformë e përbashkët edhe me opozitën, edhe me Presidentin, edhe mazhoranca - Qeveria, delegacioni - unë kam frikë se krejt ky proces do të na kthehet në bumerang dhe nuk do ta doja këtë. Ne Nisma kemi besim në delegacionin qeveritar, pa dyshim. Përndryshe, nuk do ta jepnim mbështetjen sikur të mos kishim besim.

Por, ajo që edhe i kemi thënë zotit Limaj, është një përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe, sepse dialogu me Serbinë ka filluar në vitin 2011 dhe kanë hyrë e kanë dalë shumë ministra, zëvendëskryeministra, kryeministra... por një është i pandryshueshëm, Hashim Thaçi, i cili tash në cilësinë e Republikës, e presidentit të Republikës, do të jetë sërish aty me një agjendë, për të cilën edhe zoti Limaj, edhe zoti kryeministër, edhe Qeveria... besa opozita, s'po flas për opozitën, sepse ata mund të kenë edhe motive elektorale, nuk dua të hyj e t'i përfshij në këtë, kanë arsye të tjera, sepse nëse nuk falen gabimet që bëhen ndaj atdheut, atëherë nuk duhet t'ia falin as LDK-së, ta zëmë kolegët e Vetëvendosjes, sepse LDK-ja e ka sjellë Asociacionin, LDK-

ja e ka sjellë demarkacionin me Malin e Zi. Pra, mesazhi që ata përcjellin është se janë bërë gabime dhe kur të jesh në pushtet nuk të luftoj, si të vish në pozitë unë prapë t'i fal, sepse qëllimi im është tash nëpërmjet teje ta rrëzoj tjetrin.

Pra, unë nuk dua të polemizoj, as nuk dua të mbështes, as nuk dua askush ta shoh fjalën time, fjalën tonë si të nxitur, apo të mbështetur nga opozita. Unë thjesht i ngre shqetësimet e mia dhe kërkoj, zoti kryeministër Haradinaj, zoti Limaj, kryetari im dhe kryesues potencial i delegacionit, besoj në emër të të gjithë deputetëve, jo vetëm në emrin tim, në emër të shumë qytetarëve, që nëse në këtë hapësirë të shkrihet në një platformë të përbashkët agjenda dhe kërkesat e të dy delegacioneve, e Qeverisë dhe e Presidentit, të vini këtu sërish në Kuvend dhe të na thoni se një gjë e tillë është e pamundur, ose po, kemi arritur ta shkrijmë në një platformë të përbashkët konceptin edhe të Presidentit, që e ka, dhe të Qeverisë, dhe pastaj së bashku ta miratojmë platformën dhe të vazhdojmë të bisedojmë me Serbinë.

Unë jam i vetëdijshëm, siç jeni edhe ju dhe të gjithë aktorët vendorë e ndërkombëtarë, se rruga për t'i zgjidhur problemet me Serbinë është dialogu, por dialogu i cili nuk shkon në dëm të asaj që deri më tani e kemi arritur. Ju e dini dhe të gjithë e dimë që këtu e kemi një rrugëtim 20-vjeçar dhe rezultatet e këtij rrugëtimi 20-vjeçar nuk guxojmë t'i rrezikojmë për asnjë çast dhe për asnjë arsye dhe për asnjë person, qoftë ai kryeministër, qoftë zëvendëskryeministër, qoftë president, apo parti politike. Unë duke kërkuar mirëkuptim, ju falënderoj për vëmendjen.

**KRYETARI:** Faleminderit! Albert Kinolli, nga 6+.

**ALBERT KINOLLI:** Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pa dashur të lëshohem në diskutim dhe të përsëriten ato që u thanë më herët dhe duke pasur parasysh që para vetes e kemi vetëm një pikë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ekipin negocator, unë në emër të Grupit Parlamentar 6+ dëshiroj të them se ne si Grup Parlamentar 6+ e mbështetim këtë propozim-vendim të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Tani jemi në radhën e deputetëve të paraqitur për fjalë. Donika Kadaj-Bujupi.

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këto javët e fundit ka pasur një informim, dezinformim, shqetësim të opinionit publik, me ç'rast është diskutuar tërësia territoriale e Republikës së Kosovës, është interpretuar, keqinterpretuar, keqpërdorur, pra ka pasur tensione dhe shqetësime, të cilat e kanë shqetësuar edhe opinionin, edhe qytetarët. Në gjithë këtë vorbull të informatave ka qenë kryeministri, i cili e ka bërë të qartë qëndrimin e tij dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës për tërësinë territoriale dhe prandaj sot e përkrahim këtë vendim.

Mirëpo, krahas vendimit, konsideroj se duhet t'i përfshijmë edhe dy pika shtesë, të cilat nëse më lejoni po i propozoj sot para jush. E para, territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pandashëm dhe askush nuk ka mandat të negociojë për territorin e Republikës dhe, e dyta, Ekipi Negociator obligohet të raportojë në Kuvend pas çdo raundi të bisedimeve.

E dini të gjithë se jemi dëshmitarë të marrëveshjeve të dëmshme të 25 gushtit 2015, të cilat na kanë mbajtur të bllokuar për pothuajse tre vjet dhe është mirë paraprakisht, meqë jemi në një fazë të re ose përmbyllëse, ta quajmë si të doni, si Kuvend, si Republikë, t'i marrim masat me kohë dhe ta thërrasim në përgjegjësi me kohë, edhe Ekipin Negociator, edhe të gjithë ata të cilët nesër do të marrin vendime në emër të këtij Kuvendi dhe në emër të qytetarëve të Republikës.

Prandaj, kërkoj mirëkuptimin nga ju si Qeveri, që krahas vendimit të cilin e thash se do ta përkrahim, t'i shtojmë edhe dy pika, të cilat në vija të trasha do të jenë një platformë për Ekipin Negociator, që pritet ta fillojë së shpejti punën e vet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Milaim Zeka, urdhëro!

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryetar!

Me siguri se prej Konferencës së Rambujesë e deri më sot Kosova nuk ka qenë asnjëherë në historinë e vet dymijëvjeçare në një udhëkryq më të rëndësishëm, kur do të përcaktohet fati dhe ardhmëria e vendit tonë, Kosovës.

Edhe një pjesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe opozita, po them një pjesë, për arsye se ajo pjesa reale e Lidhjes Demokratike të Kosovës, siç është Lutfi Haziri, ose Agim Veliu, ose Teuta Rugova që është këtu, nuk janë për sabotimin e bisedimeve dhe të dialogut me Serbinë.

Unë mendoj që po të mos ishte ajo pjesa që ka dalë si shartim nga Bujar Bukoshi, që e prezanton atë pjesën radikale tash të bojkotimit të Serbisë, por të ishte vërtet fryma e presidentit Rugova, sot nuk do të mungonte Lidhja Demokratike e Kosovës këtu në sallë. Imagjinojeni forcën politike të cilën e ka pasur doktor Ibrahim Rugova në bisedimet e Rambujesë. Imagjinojeni sikur

presidenti Rugova së bashku me Fehmi Aganin dhe pjesën tjetër të Lidhjes Demokratike të Kosovës ta sabotonin delegacionin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës çfarë rezultati do të kishim për fatin e Kosovës. Do ta kishim një fat katastrofal.

Prandaj, mbi bazën e kësaj, sot nuk është duke u diskutuar interesi i një partie, interesi i një individi, por është duke u diskutuar thjesht fati i vendit. Neve nuk na intereson të flasim këtu për Hashim Thaçin si individ, por ne po flasim për institucionin e presidentit Thaçi, i cili së bashku me delegacionin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe së bashku me opozitën do t'i udhëheqin bisedimet me Beogradin.

Çdokush që flet, ose që ka folur deri më sot, është bazuar vetëm mbi bazën e thashethemeve dhe të spekulimeve. As Beogradi nuk ka platformë të bisedimeve deri më sot, as Kosova nuk ka platformë të bisedimeve deri më sot. Kur të vijmë tek drafti final i arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare, duke pasur besimin absolut te delegacioni i Qeverisë së Kosovës në krye me zotin Limaj dhe të gjithë pjesëtarët tjerë dhe kur të na paraqitet drafti final i kësaj marrëveshjeje, atëherë ne si Parlament dhe si deputetë mund të ulemi dhe mund të bisedojmë.

Deri më sot, ne po e shohim opozitën dhe pjesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës që është duke notuar në zgjedhje të parakohshme dhe janë duke folur vetëm për ta trullësuar elektoratin, vetëm për të fituar vota. Për të qenë politikanë është gjëja më e thjeshtë dhe më e lehtë. Për të qenë burrshtetas, është puna më e rëndë për një njeri, prandaj edhe nga zoti kryeministër, edhe nga zoti Limaj, edhe nga pjesëtarët tjerë të delegacionit kërkohet të merret përgjegjësi, sepse Kosova nuk mund të vazhdojë edhe 20 vjet, edhe 50 vjet, edhe 100 vjet të jetojë në erën e luftës me Serbi. Ne duhet njëherë e përgjithmonë, ashtu siç e kanë rrëzuar përtokë suedezët dhe danezët urretjtjet 700-vjeçare ndërmjet tyre, ne duhet të luftojmë që ta rrëzojmë urretjtjen ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, urretjtjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo urretjtje mund të zhduket vetëm nëpërmjet bisedimeve, vetëm nëpërmjet dialogut. Prandaj, mbi bazën e kësaj, ne do ta mbështetim këtë dialog.

Ata që mendojnë të luajnë me fatet e Kosovës për hir të elektoratit, për hir të asaj çka më tha ky e çka më tha ai, le ta kuptojnë fort mirë se në arritjen përfundimtare të kësaj marrëveshjeje do të mbeten me gishta në gojë. Ne nuk e kemi as dyshimin më të vogël se dikush nga delegacioni do të tradhtojë interesat e Kosovës, prandaj fjala tradhti e shantazh që po përdoren janë duke u bërë vetëm për marketing politik.

Prandaj, edhe një herë, arsyeja që dola këtu, desha t'i sqarojë qytetarët e Kosovës, as opozitën, as një pjesë të LDK-së që për fatin e zi të Kosovës kanë marrë vendime shumë më të rënda dhe të dëmshme për Kosovën, siç është Asociacioni, siç është pengesa për krijimin e ushtrisë së Kosovës. Të gjithë e dinë se Isa Mustafa është përgjegjësi kryesor pse ne sot në Kosovë nuk kemi ushtri. Inati i tij politik në raport me Hashim Thaçin e ka lënë Kosovën pa ushtri.



Sa i përket pjesës së Vetëvendosjes, ne e dimë të gjithë i madh e i vogël se Vetëvendosja e ka të mbjellë, të programuar në trurin e vet vetëm idenë e refuzimit, gjithçka për të refuzuar, gjithçka për të rrëzuar përtokë, asnjëherë nuk na kanë sjellë një platformën, mbi bazën e kësaj platforme ne mund të shkojmë në bisedime. Në qoftë se mendon opozita se janë më të zotë për të udhëhequr bisedimet me Serbinë, e jani të bisedojmë dhe ta bëjmë kryetar të delegacionit ndoshta deri nesër pas tre muajve ose Albin Kurtin ose z. Hoti. Të mos mendojë dikush se z. Limaj ose pjesa tjetër e delegacionit e kanë marrë me lezet këtë farë pune. Kurrfarë lezeti nuk është të shkohet në Bruksel për të biseduar me Vuçiqin, i kemi një milion plagë, por ne e dimë se në Dejton, përtej gjithë luftës që është bërë ndërmjet Bosnjë-Hercegovinë dhe mes Kroacisë dhe në fund janë ulur tre liderët Milosheviqi, Tugjmani dhe Alija Izetbegoviqi dhe e kanë arritur një marrëveshje të paqes.

Prandaj, në fund po them se çdo bojkotim për bisedime me Serbinë është bojkotim për ardhmërinë e Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fatmir Limaj e ka fjalën. Fatmir Xhelili, më fal Fatmir, se sot je kryeprotagonist.

**FATMIR XHELILI:** Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të nderuar deputetë,

Përshëndetje për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar,

Ideja për krijimin e ekipit dhe vendimi për krijimin e ekipit për negociata është ide e qëlluar dhe ide që duhet përkrahur. Nuk dua të lëshohem në momentin dhe periudhën të cilën jemi duke kaluar sepse e potencuan disa prej deputetëve dhe z. Zeka, që tha se është një prej periudhave më të rëndësishme të historisë sonë, ndoshta edhe më e rëndësishmja se shpallja e pavarësisë, por ndoshta edhe më e rëndësishme edhe se ndoshta edhe vetë lufta, e cila është zhvilluar.

Produktet e punës që do të dalin prej këtij dialogu janë produkte të cilat do të reflektojnë në dimensionin kohor bukur gjatë dhe nuk do të përcaktohem për gjatësinë kohore. Është mirë që të gjithë janë për dialog, është mirë që kemi filluar prej tash t'i qasemi dialogut në mënyrë serioze, mirëpo ndoshta këto përgatitje ka qenë dashur të bëhen edhe më herët. Nuk po hyj të diskutoj pozicionin e opozitës se a ka të drejtë apo nuk ka të drejtë në qasjen dhe mënyrën të cilën e ka zgjedhur për ta përkrahur apo kundërshtuar dialogun, por e kisha lutur z. kryeministër për ekipin që e ka propozuar a i është qasur opozitës për t'i kërkuar emrat dhe partive opozitare për të qenë pjesë e ekipit të dialogut.

Po më duket se një radhitje e tillë pa emrat e opozitës dhe pa iu qasur opozitës edhe për të kërkuar vazhdim të diskutimeve për t'iu bashkuar ekipit, mos po dalim pak joserioz, pasi normalisht askush nuk pranon që të jetë pjesë e dytë e ekipit negociator. Ne jemi duke negociuar dhe do të negociojmë me Serbinë dhe pse mos të diskutojmë me opozitën? Ndoshta e keqja e

madhe e kësaj çështje është se kemi një retorikë tejet të nxehtë patriotike dhe zgjidhja më e mirë ndoshta për të diskutuar gjakftohtë, për të qenë racional, për të zhvilluar një politikë racionale, kishte qenë që të jenë seancat e mbyllura. Në seancat e mbyllura me siguri që edhe zërat e edhe logjika e të menduarit do të kishte qenë më gjakftohtë, më e arsyeshme, më racionale, më largpamëse dhe ishin marrë me interesat e Kosovës për së paku 50 vjetët e ardhshme dhe nuk ishin marrë me interesat e partive politike dhe grupet brenda partive politike, që janë interesa të politikës ditore. E përmendi Bilalli që mund të ekzistojnë lehtë që mund të shkojnë dy apo tri grupe ndoshta në bisedime. Populli jonë ka pasur përvojën kur në Londër kanë qenë disa ekipe biseduese dhe në Versajë kanë qenë po ashtu disa ekipe biseduese dhe kanë diskutuar me të gjithë tjerët ndërkombëtarë, por nuk kanë diskutuar asnjëherë mes vete.

Zoti kryeministër për hir të situatës dhe zoti kryetar i Kuvendit që njëkohësisht është edhe kryetar i partisë, shfrytëzoni mundësitë edhe autorizimet tuaja, por edhe anën njerëzore patriotike që të vëni një kontakt të drejtpërdrejt me përfaqësuesit e opozitës, gjegjësisht me liderët e tyre dhe nuk kemi nevojë edhe për nguti të madhe. Ekipi është i qëlluar, por ekipi duhet të jetë gjithësesi i plotësuar me përfaqësues të opozitës që në start, në mënyrë që opozita të mos e ndiejë veten si të dorës së dytë. Është mirë që opozita nuk është deklaruar asnjëherë kundër dialogut. Kisha bërë edhe një lutje njerëzore që të tentoni edhe një herë t'i drejtoheni opozitës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Sot jemi duke folur vetëm për pjesën e ekipit negociator. Kisha kërkuar nëse ka mundësi Qeverisë që të fokusohet pastaj gjithësesi ekipi negociator, do të kemi edhe seancë tjetër sepse do të ndërtohet edhe platforma e cila do të jetë konsensuale pozitive dhe opozitive. Kjo është çështja. Sot jemi vetëm në bazën e krijimit të grupit negociator të Qeverisë, ta kemi parasysh. Edhe kjo ka qenë një thirrje e vazhdueshme dhe pastaj. Duda Balje, fjala për ju.

**DUDA BALJE:** Zahvaljujem!

Poštovani premijeri,

Poštovani ministri,

Kolege poslanici!

Mi kao predstavnicu Bosnjačke zajednice, da budem iskrena, dugo smo razmišljali da li da podržavamo ovaj tim za pregovore, s obzirom na to da Bošnjaci nisi uključeni u ovom timu, i smatrali smo da je jako bitno da oni budu tu. Gospodine Fatmir, ja sam gotovo sigurna ukoliko u ovom timu, zajedno sa premijerom, i sa svima ko odlučujete, da se ubace Bošnjaci, tim će biti mnogo kvalitetniji. Mislim da se na obraćam na probleme koje se dešavaju u Bošnjačkoj mahali, i svim bošnjacima koje živi u diskutabilnim i probematičnim delejevima Kosova, koji su u konekciji sada sa Srbijom.

Danas u razgovoru sa premijerom i sa njevogom timom dobili smo čvrsta obećanja da će Bošnjaci biti aktivni deo ovog pregovoračkog tima i čitavog ovog procesa, i to je bilo razlog zbog čega smo odlučili da podržimo ovaj tim, i nadam se da će to tako biti, jer smatram da nikako iz nenjih razloga Bošnjaci iz ovakvog tima ne treba biti izljučeni, i da trebaju da predstavljaju probleme bošnjaka koje se nalazi ovde na Kosovu. Hvala!

**KRYETARI:** Faleminderit! Daut Haradinaj e ka fjalën.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit, kryetar!

Shumë shkurt. Vetëm dua ta bëjë të qartë se do ta jap votën për, për ekipin negociator dhe kushti i vetëm do të jetë që në asnjë variant të jetë në tavolinë, pjesë e diskutimit territori i Republikës së Kosovës që është shpallur më 17 shkurt 2007. Pra, nuk kam asnjë gjë më shumë. E kanë besimin tim. Shpresoj të kompletohet ekipi edhe me opozitë, por edhe një herë e përsëris, në rast se bëhen këso lojërash, këtu kemi për të ardhur të marrim mosbesimin, ose të kundërtën, votën kundër.

**KRYETARI:** Faleminderit! Blerim Kuçi, urdhëro!

**BLERIM KUÇI:** Faleminderit, kryetar!

Edhe unë do të flas shkurt, por ajo që më shtyri ta marr fjalën ka të bëjë e para me, zoti Xhelili e përmendi çështjen e renditjes, e unë mendoj që renditja e opozitës ose e përfaqësuesve të opozitës është vetëm një rastësi, por nuk ndryshon për nga rëndësia të që jesh ose jo anëtar i këtij grupi negociues ose grupit të dialogut. Po ashtu desha edhe njëherë ta lus zotin kryeministër, jo ta lus, por edhe në një debat tjetër i kam bërë thirrje që të bëjë përpjekjet maksimale si kryeministër i vendit që ta ofrojë opozitën, ta gjejë mënyrën, ngase çdoherë ka një mënyrë për ta ofruar opozitën që të jetë pjesë e këtij ekipi.

Po ashtu i bëj thirrje edhe opozitës që ta gjejnë mënyrën që edhe ata që të jenë bashkë me ekipin e sotëm që do të propozohet. Është një thënie që “kush dëshiron të mësojë diçka e gjen mënyrën, kush nuk dëshiron të mësojë e gjen arsyen”! Unë besoj se kësaj radhe duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij epilogu, opozita nuk ka arsye që të mos jetë pjesë e këtij ekipi. Siç mendoj dhe jam i bindur që kryeministri i Republikës së Kosovës do ta gjejë mënyrën për të bashkëpunuar që pjesë e këtij ekipi të jetë edhe opozita. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zenun Pajaziti, urdhëro!

**ZENUN PAJAZITI:** Faleminderit, kryetar!

Pa dashur të hyj tani në debat po ashtu mbështes qëndrimin e grupit parlamentar në aprovimin e këtij grupi, por desha në frymën e zotit Xhelili dhe zotit Kuçi po ashtu!

Kohëve të fundit ky Parlament ka pasur sfida dhe vendime të vështira dhe në disa prej tyre jemi vonuar. Dy vite i kemi humbur për demarkacionin dhe kemi ardhur në një pikë të njëjtë. Mënyra sesi sot e keni sjellë zoti kryeministër ngutshëm në një seancë të jashtëzakonshme, e i keni pasur dy muaj pushim. I gjithë ky muaj ka qenë me sinjale dhe porosi nga miqtë e partnerët por edhe nga qytetarët që duhet të jemi të vëmendshëm për këtë proces, edhe të gjithë po dimë se është një gatishmëri e të gjithëve që ta përmbyllim për një kohë të gjatë procesin negociator me Serbinë, tregon që ka diçka që duhet përmirësuar.

Mendoj dhe shpresoj që nuk do të vini prapë me një vendim tjetër dhe shpresoj që ky ekip ta kryejë detyrën e vet, por ta dini që vendit tonë tashmë i vyen një proces gjithëpërfshirës, po them gjithëpërfshirës sepse ne këtu e kemi akuzuar opozitën sepse po e përdorë këtë agjendë për nevoja të veta elektorale, kjo do të ndodhë gjithnjë ka ndodhur edhe në të kaluarën, kërkojmë përgjegjësi më të madhe të tyre, por shumica e ka për detyrë që gjithnjë të krijojë një ambient të tillë ku në procese të tilla të kemi një proces më kredibil. Unë ju ftoj që të jeni më aktivë në këtë drejtim edhe në raport me opozitën edhe me shoqërinë civile edhe me grupet e interesit, me të gjithë qytetarët e Kosovës. Edhe një koordinim të brendshëm institucional me presidentin dhe me të gjithë dhe po ashtu ta dini që këtij vendi, këtij procesi i nevojitet edhe një ekip kredibil, përfaqësues me të gjithë.

Është shumë lehtë sot që ta votojmë, por shumë më vështirë do ta keni ju që ta udhëhiqni këtë proces para qytetarëve, para interesave të vërteta të këtij vendi. Unë shpresoj po ashtu sikurse kolegët e mi që në ditët në vijim ta bëni punën e duhur të punoni me të gjithë, në mënyrë që procesi të ecën sa më mirë që është e mundur. Faleminderit!

**KRYETARI:** Bekim Haxhiu, urdhëro!

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke mbështetur qëndrimin e grupit parlamentar konsideroj që ka qenë më se e domosdoshme fillimisht krijimi i unitetit për ekipin dialogues brenda koalicionit qeverisës për çfarë mendoj se është bërë një hap i mirë përpara duke shpresuar që edhe vet opozita ta krijojë unitetin brenda saj, që të ketë edhe ajo emra dhe ekipin dialogues dhe me këtë pastaj kërkohet një unitet i përgjithshëm i gjithë spektrit politik.

Gjatë këtyre muajve të fundit më shumë kemi parë polarizime edhe zhurma të cilat i kanë i përngjarë një fushate elektorale sesa që kemi pasur argumentime për çështje të cilat na takojnë dhe për çka jemi të thirrur që të mbrojmë interesin kombëtar dhe nacional, e në veçanti kur kemi

të bëjmë me dialogun me Serbinë dhe fazën finale e cila do të përcaktojë për shumë vite të ardhmen e këtij vendi dhe të ardhmen e fëmijëve tanë.

Për fat të keq, kohëve të fundit kur kemi pasur diskutime për tema të mëdha na ka munguar uniteti që çështjet t'i peshojmë bashkë pozitivisht dhe opozitivisht duke i marrë për bazë edhe bisedimet me spektrin jo politik me shoqërinë civile dhe me personelin akademik të cilët do duhej të ishin pjesë aktive e këtij dialogu. Prandaj, po kërkoj duke qëndruar besnik në atë që, kur në diskutimet e kaluara kam propozuar që të krijohet një unitet, mendoj që jemi ardhur në një fazë që vërtetë uniteti është mëse i domosdoshëm dhe që kërkojmë që vërtetë të gjejmë elemente të cilat na bashkojnë jo ato të cilat na ndajnë, sepse kemi të bëjmë me interesa nacionale dhe duhet të punojmë bashkë.

Kur kam propozuar në seancën e fundit për dialogun Bekim Jasharin për kryetar dhe për udhëheqës të dialogut, qëllimi ka qenë që vërtetë të krijohet uniteti brenda të gjithë spektrit politik, shoqërisë civile dhe botës akademike. Mendoj që kjo ka qenë më se e nevojshme dhe këtu tani jemi në një fazë e cila po shkon kah përafrimi i krijimit të unitetit të brendshëm, duke i anashkaluar polarizimet politike të cilat kanë qenë në muajt e fundit. Duke i dhënë mbështetje këtij fillimi të krijimit të ekipit dialogues, kërkoj që vërtet ky ekip të punojë edhe më shumë me partitë opozitare po edhe me shoqërinë civile, edhe me botën akademike që të krijohet uniteti. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje kryesues,

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Qytetarë,

Kor diplomatik,

Medie,

Këtu po më duket që nuk ka arsye të shtojmë shumë, por ka disa elemente që sot po formohet një ekip negociues që do ta përfaqësojë Kosovën, por sigurisht që është një mungesë e madhe nëse nuk arrihet që të përfshihet edhe opozita.

Ne kemi nevojë që të jemi të bashkuar për arsye se ne po diskutojmë për Republikën e Kosovës. Ky vend është i çdo qytetari të Republikës së Kosovës, prandaj është e rëndësishme që të punohet edhe më shumë në mënyrë që opozita të jetë pjesë e këtij delegacioni dhe i kisha bërë thirrje ekipit negociues që të kenë parasysh çka diskutohet atje, për çka negociohet për arsye që

pastaj vjen prapë këtu në Parlament dhe sigurisht që nëse ka diçka që nuk është konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës të mos mund të kalojë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Deliu, urdhëro!

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit, zoti Haliti!

Natyrisht që ne e mbështesim këtë ekip negociator të Qeverisë. Është vetëm një kërkesë e imja që në këtë fazë të diskutimeve të trajtohet edhe çështja e zbardhjes së fatit të të pagjeturve, mendoj që është njëra ndër pikat që do duhej që të diskutohej nga ky ekip sidomos në fazën përmbyllëse të dialogut. Natyrisht se unë i bashkohem kërkesës së kolegëve të mi që ekipi të raportojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të ketë gjithëpërfshirje dhe transparencë në mënyrë që të evitohet çdo huti për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe po ashtu duhet të ketë një koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës sa i përket fazës përmbyllëse të dialogut.

Po ashtu pres që të kemi një bashkëpunim ndërmjet aktorëve pozitivë-opozitivë për të pasur gjithëpërfshirje në këtë proces. Besoj që partitë opozitare do të duhej që në këtë fazë t'i lënë anash inatet e tyre politike dhe të bëhen pjesë e një procesi përmbyllës të fazës së dialogut. Do të thotë po ripërsëris, çështja e zbardhjes së fatit të të pagjeturve duhet të jetë njëra prej pikave që duhet të diskutohet në këtë fazë përmbyllëse. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Atëherë, meqenëse e kemi një konsultim, propozoj që t'i kemi 15-20 minuta pauzë!

\* \* \*

*E mërkurë, 5 shtator 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 4 shtator 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jemi në vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme të thirrur nga kryeministri i Republikës së Kosovës. Debati parlamentar për këtë pikë të rendit të ditës, e cila ka qenë - Emërimi i Ekipit Negociator për Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, ka përfunduar. Kemi qenë në fazën e votimit. Me aq sa mund të konstatoj nga Administrata, për t'u futur në procesin e votimit nuk kemi kuorum, për këtë arsye ne duhet të mendojmë që vazhdimi i seancës të jetë në momentin kur të ketë kuorum. Kështu që, ne të njëjtën kohë e kemi pasur edhe një kërkesë po ashtu për seancë të jashtëzakonshme nga kolegët e opozitës. Tani ne do t'i respektojmë të gjitha procedurat, pavarësisht se përpjekja ime sot gjatë tërë ditës ka qenë që të jemi bashkërisht, të bisedojmë bashkërisht, në të njëjtën kohë të marrim edhe vendime bashkërisht, të cilat janë në interesin e vendit dhe të qytetarëve.

Në këto rrethana, seancën e jashtëzakonshme të radhës, të kërkuar nga 51 deputetë nënshkrues do ta mbajmë në orën 19:30. E përsëris: Sonte, në orën 19:30, do të kemi fillimin e seancës së jashtëzakonshme të kërkuar pothuajse për të njëjtën temë, vetëm se tani nga kolegët e opozitës. Faleminderit!

\* \* \*

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*